



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ndryshimet klimatike” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Besnik Baraj, Dritan Bici, Eglantina Gjermeni, Gjetan Gjetani, Ilir Beqaj, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Rrahman Rraja, Ardit Konomi, Nimet Musaj, Arlind Caçani, Halit Valteri, Kujtim Gjuzi dhe Zef Shtjefni.

Mungojnë:

Lefter Koka.

Të ftuar:

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Athanas Karaja – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marika – Drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Vilma Kola – Drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Eneida Rabdishta – Specialist i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të datës 17.09.2019.

Sot kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ndryshimet klimatike”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Gjithashtu, presim edhe rekomandimet e komisioneve të tjera, si, për shembull, të Komisionit të Integritetit, i cili nuk e ka përfunduar ende shqyrtimin e këtij projektligji.

Ne kemi bërë një seancë paraprake për prezantimin e këtij projektligji nga ana e relatorit, zotit Besnik Baraj, por edhe nga zëvendësministrja e Turizmit dhe Mjedisit, e cila është prezente. Pra, ne kemi ezauruar vetëm pjesën e prezantimit të këtij projektligji, kurse sot do të vazhdojmë me pyetje-përgjigje dhe diskutime. Nesër do ta diskutojmë projektligjin nen për nen, meqenëse sot nuk mund ta përfundojmë, për shkak se presim edhe opinionet e komisioneve të tjera.

Pra, nëse do të bini dakord, ne do ta vazhdojmë këtë mbledhje me pyetje-përgjigje dhe diskutime.

Zoti Kujtim Gjuzi ka kërkuar fjalën.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua t’u bëj me dije kolegëve të komisionit se, duke filluar nga sot, unë jam pjesë e Grupit Parlamentar të Partive të Djathta. Kjo është gjëja e parë që doja t’ju thosha dhe mendoja se kryetari duhet ta dinte.

Niko Peleshi – Urime dhe suksese!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit!

Kur të më jepni leje, do të flas për pjesën e dytë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Urime edhe një herë, zoti Gjuzi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka relatori, zoti Baraj. Më pas do të vazhdojmë me pyetjet dhe diskutimet e anëtarëve të komisionit.

Besnik Baraj – Edhe një herë, dua të sjell shqetësimin tim lidhur me këtë ligj, për faktin se mendoj se është i parakohshëm. Ky ligj bën fjalë, këtu do të doja edhe mendimin përfaqësuesve të ministrisë, për çdo operator që ka një instalim që emeton gaze serrë dhe të gjitha aktivitetet industriale, qofshin ato minore. Këtu kam parasysh furrat e pjekjes së

bukës, si dhe aktivitete të ngjashme, të thjeshta e të vogla, të cilat janë me mijëra në Shqipëri. Të gjitha këto djegin karburant dhe, për pasojë, emetojnë minimalisht CO₂. Sigurisht, CO₂-shi është një nga përbërësit sasiore, që emetohet si gaz serrë dhe të gjitha këto aktivitete duhet t'i nënshtrohen një vetëmonitorimi, duhet të bëjnë aplikim për licencë e të tjera, siç parashikohet në nenet 8 dhe 9 e kështu me radhë. A mendoni që kjo mund të sjellë një *shok*, për shkak të mungesës së kapaciteteve të tyre për të kryer monitorimin? Unë mendoj se kjo ndodh edhe për shkak të mungesës së kapaciteteve të institucioneve të pavarura për të kryer brenda një afati kaq të shkurtër monitorimin dhe për të bërë raportet për t'i ndihmuar, sepse në finale ata do t'i bëjnë vetë të gjitha këto. Në qoftë se janë të paaftë, do të kërkojnë ndihmë diku tjetër dhe këtu fillon edhe sharlatanizmi ynë që i japim në mënyrë fiktive ose i japim vetëm në ato raste kur ata paguajnë. Unë mendoj se kjo është një premisë për të shkaktuar penalitete dhe frenime të këtyre aktiviteteve. Nëse ne e miratojmë këtë javë projektligjin, ai hyn në fuqi në muajin shkurt dhe në muajin shkurt të çdo vitit të gjitha industritë duhet të raportojnë. A i bëjmë dot ne këto? A mos ndoshta do të ballafaqohemi me një situatë vërtet që mund të kolapsojë, në qoftë se ligji do të zbatohet rigorozisht? Unë kam bindjen se ky ligj, minimalisht, nuk duhet të futet në fuqi pa kaluar dy vjet. Kjo gjë duhet të shoqërohet nga ministria përkatëse me një axhendë rigoroze për trajnimin e kapaciteteve të AKM-së, ministrisë, si dhe të informohet publiku për të gjitha këto aktivitete për t'i plotësuar këto kërkesa, që janë vërtet mjaft rigoroze, nëse do të zbatohen. Kaq kisha.

Niko Peleshi –Po, urdhëroni zoti Bitri.

Më pas fjalën e ka zëvendësministrja.

Robert Bitri –Zoti Baraj tha se hyrja në fuqi e ligjit mund të shtyhet 2 vjet. Zëvendësministrja në takimin e parë tha se ne duhet t'i paraprijmë dhe paraprija e parë është projektligji. Tani, gjithmonë do të ketë një fillim, ndaj në qoftë se qeveria e shikon të arsyeshme që ky moment ka ardhur, unë gjykoj se ne duhet ta mbështesim qeverinë. Ne mund të kërkojmë nga qeveria që ta shoqërojë hyrjen në fuqi të projektligjit me një program të qartë dhe me të gjitha detyrat. Zoti Baraj është më kompetenti i kësaj fushe dhe mund të jetë një hartues shumë i mirë i detyrave të lëna nga qeverinë deri në hyrjen në fuqi të ligjit. Unë kështu e gjykoj.

Niko Peleshi - Po, urdhëroni!

Ornela Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit të gjithë të pranishmëve!

Faleminderit, zoti Baraj!

Realisht unë e vlerësoj jashtëzakonisht shumë çdo fjalë që ju thatë, pasi ju e keni parë në detaje dhe në çdo pikë ligjin. Unë do të doja të specifikoja vetëm një gjë që është në anekset e ligjit.

Së pari, në ministri ka 3 vjet që po punohet për këtë ligj dhe nuk është punuar vetëm nga ekspertët ministrisë, por edhe me një donacion të madh të Bashkimit European. Pra, ky ligj është punuar nga kompani vendase dhe të huaja.

Ligji është në përputhje me direktivën, por jo plotësisht. Arsyeja është se ne nuk e kemi parë të arsyeshme që të përkthejmë *mot a mot* direktivën, pasi vendi ynë nuk i ka kushtet për ta zbatuar. Prandaj, ne kemi mbetur vetëm te monitorimi dhe te raportimi për ndryshimet klimatike dhe ky ligj prek vetëm monitorimin dhe raportimin për ndryshimet klimatike. Kjo është bazuar në të gjitha rregulloret e BE-së dhe në të gjitha detyrimet që ne kemi si vend për raportimin tonë në Bashkimin Euripain në këtë fazë ku jemi aktualisht. Ju thoni se për çdo operator ligji është i parakohshëm dhe se çdo operator, duke nisur nga furrat e bukës, të cilët emetojnë dyoksid karboni në ajër, do të duhet të raportojnë për shkak të këtij ligji. Në fakt, në aneksin e këtij ligji specifikohet se janë vetëm 13 kompani të evidentuara, të cilat do të duhet të raportojnë. Arsyeja është se ka një formulë përlllogaritjeje për shkak të emetimeve në ajër. Bizneset dhe kompanitë, të cilat emetojnë dyoksid karboni në ajër, nuk do të preken të gjitha nga ky ligj. Pra, janë vetëm 13 kompani, të cilat kanë një nivel shumë të lartë të shkarkimeve në ajër të dyoksidit të karbonit dhe gazeve të tjera që prekin efektet serrë, të cilat duhet të raportojnë. Ndër to mund t'ju përmend Kurumin, kompanitë e prodhimit të çimentos, ALTEA –n e të tjera, pa dashur t'i përmend të gjitha kompanitë. Pra, janë vetëm kompanitë e mëdha, të cilat kanë shkarkime të jashtëzakonshme në ajër dhe të gjitha këto të vlerësuara dhe të përlllogaritura sipas formulës, që parashtrohet në anekset e ligjit.

Lidhur me çështjen e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe me mënyrën se si ato raportojnë, vetëm këto 13 kompani do të preken nga ky ligj, të cilat, së paku në 4 vjetët e parë të implementimit të këtij ligji, do të duhet të shtojnë në vetëvlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis një aneksrabort për shkarkimet e gazeve me efekt serrë. Pra, vetëm këto 13 kompani do të duhet ta bëjnë këtë raport. A kemi ne ekspertizë për ta bërë këtë gjë? Kompanitë janë kaq të mëdha dhe kanë kaq shumë shkarkime sa edhe, në qoftë se nuk gjejnë një ekspertizë brenda vendit, sigurisht që mund ta marrin edhe jashtë, por unë jam e bindur se ekspertiza, që ne kemi sot në vend, mund t'i mbulojë 13 kompanitë që preken në këtë ligj. Pikërisht për faktin që ju thoni se ky ligj është i parakohshëm, ne kemi menduar që ai të hyjë në zbatim 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe, nga ana tjetër, do të duhet që brenda 4 vjetëve të

para të këtij ligji të rishikohet, në qoftë se ka pasur qoftë edhe një problem të vogël në aspektin e implementimit të tij. Pra, ne do të japim vetes 4 vjet kohë për ta rishikuar dhe për të futur edhe targete të tjera që, në fakt, i rregullon direktiva, duke nisur që nga targetimi i gazeve me efekt serrë, duke përfunduar te raportimi, të cilin ne kemi prekur. Pra, raportimi dhe monitorimi është një detyrim, që duhet ta përmbushin këto kompani në këtë fazë ku jemi. Duke qenë se ne i zbatojmë konventat, si dhe jemi para aderimit në Bashkimin Europian, kemi si detyrim në këto momente që të miratojmë të paktën kuadrin ligjor, që ka të bëjë me ndryshimet klimatike, prandaj ne e kemi marrë këtë iniciativë.

Faleminderit!

Benik Baraj – Së pari, unë dua të di nëse ju keni pasur takim me këto 13 kompani dhe cili ka qenë qëndrimi i tyre?

Së dyti, në fakt, pavarësisht se ju thoni se e keni transpozuar në mënyrë të pjesshme, ligji paraqet edhe elemente, që kanë të bëjnë me një praktikë, e cila sot nuk është praktikë e zakonshme në botë për *carbon catcher*, për kapjen e dyoksidit të karbonit. Përsëri, nga kjo pikëpamje, unë mendoj se zbatimi i këtij ligji në vendin tonë relativisht është i parakohshëm. Ka shumë elemente që, realisht, nuk korrespondojnë me situatën ekonomike dhe me praktikat që ne bëjmë këtu në Shqipëri. Sidoqoftë, unë tërhiqem pjesërisht në atë që gjithmonë ligji i paraprin një situatë dhe nxit që të zhvillohen këto gjëra, por shqetësimi im është që, nëse këto kompani janë pyetur, a kanë pasur reagime? Unë besoj dhe shpresoj se nuk do të shtrihet më pas jashtë këtyre 13 kompanive, në mënyrë që të mos preken.

Ornela Çuçi – Faleminderit, profesor!

Në fakt, është bërë konsultimi me publikun me të 13 kompanitë dhe ka qenë një thirrje e hapur në faqen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për një kohë dhe kanë ardhur 13 kompanitë. Madje, ky vlerësim ka qenë i reflektuar edhe në relacionin që ju do të shikoni, por, nga ana tjetër, edhe pasi ne ta kemi dërguar për të marrë vendimin e Këshillit të Ministrave për ligjin në fjalë, ka qenë një proces, i cili është zbatuar. Ju sapo iu referuat sekuestrimit të karbonit dhe unë mund t'ju them se mjedisi kushton. Ky është parim botëror: mjedisi ka kosto.

Aktualisht, ky ligj në këtë 4-vjeçar nuk ka kosto shtesë, gjithçka është parashikuar te PBA-të e të gjitha ministrive. A duhet të kemi ne më shumë teknologji për të matur të gjitha nivelet e karbonit dhe të gjitha nivelet e emetimit të gazeve serrë në të ardhmen? Po, sigurisht! Aktualisht, në Shqipëri janë vetëm 7 pika të monitorimit të shkarkimeve të gazrave në ajër dhe duhet patjetër që t'i instalojmë në të gjithë Shqipërinë këto pika monitorimi, por duhet, sigurisht, edhe të mirëmbahen, që kanë një kosto të jashtëzakonshme,

sepse është një nga zërat më të rëndësishëm sot për sot në buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, por nuk ka kosto shtesë.

Besnik Baraj – Shumë faleminderit!

Ju thatë se keni 7 pika të cilat bëjnë monitorimin. Absolutisht nuk mund të jenë përfaqësuese për të karakterizuar një sistem kaq të gjerë 7 pika. Nga ana tjetër ju thoni se nuk ka kosto, atëherë këto patjetër që duhet të shtohen si numër, të sigurohet cilësia e tyre dhe të bëhet përditësimi. Atëherë, si nuk paska kosto?!

Ornela Çuçi – Aktualisht, pikat janë të vendosura në qytetet ku janë edhe këto biznese, ndaj në këtë fazë të parë ne nuk kemi kosto shtesë. Gjithçka është e vendosur në PBA-të e ministrive, të cilat aktualisht reflektohen nga ky ligj. Sigurisht që ne kemi nevojë që të shtojmë pikat dhe jo vetëm për shkak të këtij ligji, por është e nevojshme që të shtohen pikat e monitorimit për të monitoruar cilësisë e ajrit në Shqipëri. Kjo është e drejtë dhe jo për shkak të ligjit. Pra, aktualisht pikat nuk mjaftojnë, por jo për shkak të ligjit. Ne duhet t'i ndajmë gjërat. Aktualisht, Shqipëria duhet të ketë pika monitorimi në çdo bashki dhe jemi parimisht dakord me këtë gjë, por, nga ana tjetër, këto 7 pika janë të vendosura afër qyteteve, ku ky ligj do të implementohet në këtë fazë të parë, pra afër 13 kompanive, për të cilat jemi duke folur.

Niko Pelshi – Po, zoti Beqaj.

Më pas fjalën e ka zoti Gjuzi.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Unë besoj se thelbi i shqetësimit të kolegut Baraj nuk është nëse ky ligj është sot i nevojshëm, por thelbi i shqetësimit të tij është: a jemi ne të gatshëm që, brenda 6 muajve të hyrjes në fuqi të tij, të mund ta zbatojmë në mënyrë të plotë? Të gatshëm do të thotë se duhet të jetë i gjithë vendi i gatshëm, jo vetëm institucionet shtetërore përgjegjëse. Unë nuk pajtohem 100% me kolegun Baraj, kur thotë se në vlerësimin e tij se zbatimi nuk kërkon 6 muaj, por mund të kërkojë 24 muaj, për një fakt të thjeshtë, sepse ne përsëri do të kujtohem 6 muajt e fundit. Nëse ne jemi të zotë që këtë 24 muajsh ta ndajmë në etapa, një pjesë me 6 muaj dhe një pjesë me 12 muaj, atëherë jam i gatshëm të përfshihem në një diskutim më konkret. Por gjëja që më shqetëson më shumë janë kostot, sepse për mua janë jashtëzakonisht të larta për Shqipërinë.

Po lexoj relacionin, në faqen 9 të dokumentit që kemi përpara thuhet: “Projektligji për ndryshimet klimatike parashikon hartimin e dokumentit strategjik dhe planeve kombëtare për ndryshimet klimatike. Dokumenti strategjik krijon kuadrin e përgjithshëm dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Plani kombëtar 1 dhe 2 janë pjesë e dokumentit strategjik. Kostot e

implementimit të këtij dokumenti strategjik të përcaktuara në planet e veprimit, të cilat përmbledhin masat kombëtare për implementimin e dokumentit strategjik, përbëjnë edhe kostot e implementimit të vetë ligjit”.

Faleminderit për shpjegimin dhe për tabelën. Në faqen 10 sektori i transportit, sipas asaj që ka sjellë qeveria, në vitin 2020 kërkon 16 miliardë të reja dhe në vitin 2021 kërkon 15 miliardë lekë të rinj, që do të thotë se mund të mos jenë kosto e buxhetit, por mund të jenë kosto të ekonomisë. Sipas këtij dokumenti, vitin e ardhshëm, pra në vitin 2020, na kërkohen të paktën 120 milionë euro, që është sa 1% e GDP-së, dhe po kaq vitin tjetër. Unë e di se mjedisi kushton, ne ende nuk kemi qenë të zotë t’ia mbushim mendjen opinionit shqiptar që mjedisi kushton, ashtu siç harxhojmë për t’u zbukuruar dhe pastruar vetë. Për fat të keq këto tema nuk diskutohen, ato duhet të ishin temat kryesore, me të cilat duhet të merrej opinioni publik, media e të tjera. Unë jam shumë i frikësuar nga ajo çfarë qeveria thotë, pra se sa do të kushtojë transporti vitin tjetër, e cila mund ta bëjë transportin shqiptar shumë më të kushtueshëm. A jemi gati? Nga bombat që shpërthyen në Arabi u rrit çmimi i naftës me 15% dhe nuk dihet se si do të shkojë. Prandaj e kam këtë shqetësim, zoti kryetar.

Nuk dua të zgjatem dhe nuk dua të futem në detaje, sepse ata që kanë punuar për kaq vite e dinë më mirë, por siç thuhet, sidomos nga sektorët, energjia është më pak, bujqësia është më pak dhe transporti në dy vjetët e parë ka

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të mos jenë investime, mund të jenë edhe kosto e operatorëve, nuk e kuptoj ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse ndërhyri të gjithë në grup, unë po lexoj çfarë keni shkruar.

Zoti kryetar, unë do të mbështes zotin Baraj nëse zgjatjen do ta bëjmë pjesë pjesë. Po të jetë e gjitha në bllok, ne do të kujtohem përsëri, sepse kështu e kemi ne shqiptarët, pyesim në çfarë date është provimi, nuk korrigjohemi nga kjo punë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Zoti kryetar, faleminderit!

Unë nuk bie dakord me zotin Baraj në lidhje me kërkesën që ka. Dikush mund të thotë se “lojtarët” e opozitës janë me qeverinë në këtë moment. Shumë mirë do të bëjnë, sepse unë jam me qeverinë, pra jam me ju. Pse? Në datat 19, 20 dhe 21 në Istria organizohet nga Polieco një konferencë ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, ku unë do të referoj atje për 15 minuta. Po si mundet që të kundërshtoj qeverinë në këtë rast? Prandaj jam me atë çfarë

kërkon zonja zëvendësministre, së bashku me kolegët e saj dhe e deklaroj votën hapur. Këtë radhë jam me ata, për ta mbrojtur mjedisin.

Faleminderit, zoti kryetar!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Fjalën e ka përfaqësuesi i ministrisë.

Eneida Rabdishta – Përshëndetje!

Faleminderit për analizën e detajuar!

Për sa referon deputeti Beqaj, të dhënat i takojnë strategjisë për ndryshimet klimatike. Për të sqaruar, të gjitha të dhënat e paraqitura këtu dhe vlerat financiare të pasqyruara janë të marra nga strategjitë sektoriale, ku përfshihet edhe strategjia e transportit, të cilat janë të miratuara. Pra, ne kemi futur në përllogaritjen e kostove të gjitha ato vlera që janë të miratuara në planet sektoriale dhe në strategjitë sektoriale, për këtë arsye ne themi që implementimi i strategjisë nuk ka një kosto shtesë, sepse edhe strategjia e transportit, edhe strategjia për energjinë, edhe strategjia për klimën kanë të përfshirë në përllogaritjen e vlerave ato masa dhe ata indikatorë, që janë tashmë të miratuar në buxhetet respektive të ministrive.

Për sa i takon pjesës së sekuestrimit të karbonit, të cilën e përmendi profesor Baraj, është një projekt pilot që po realizohet në zonën e Korçës, i cili ka dhënë ekspertizën për përllogaritjen e emetimeve të oksidit të karbonit në atmosferë. Nëpërmjet kësaj, 13 subjektet, të cilat ne i kemi të reflektuara, që mendohet se mund të impaktohen, në të vërtetë nuk kanë një impaktim. Impaktimi i vetëm është një shtojcë në lejen e tyre të mjedisit, që ata duhet të raportojnë dhe raportimi ka të bëjë me përllogaritjen që jepet nga formula.

Për sa i përket pjesës që i referohet projektligjit për ndryshimet klimatike, ne jemi në procesin e integritetit me komunitetin europian dhe në të gjitha progresraportet që janë bërë në vitet 2013, 2014, 2015, 2016 e në vazhdim, është shtruar për diskutim dhe është kërkuar në mënyrë impenjative, që ne të krijojmë një kuadër ligjor. Pra, ky projektligj është një ligj kuadër që i hap rrugën përgatitjes së akteve nënligjore. Unë mendoj se kjo e bën më të pranueshme për pjesën e kundërshtive, për sa i takon projektligjit për ndryshimet klimatike. Fakti që ne kemi nënshkruar marrëveshjen e Parisit në vitin 2015 është një tjetër parakusht që Shqipëria duhet të ketë një ligj për ndryshimet klimatike. Pastaj, pjesa e mekanizmave që do të rregullohet me vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat do të çojnë në një përafrim më të madh kundrejt direktivave të ndryshme që i takojnë, si: emetimit të gazeve serrë, të tregtisë, të emetimeve të karbonit apo të detyrimeve që mund të kenë operatorët do të vijojnë për një kohë më të gjatë. Pra, në këtë 6 mujor nuk ka ndonjë shtrëngesë apo ezaurim financiar, si për

shtetin shqiptar, ashtu edhe për operatorët, të cilët janë konsideruar si shkarkuesit e mëdhenj të gazeve serrë në Shqipëri.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit për shpjegimin, por këtu keni shkruar tjetër gjë. Ju flisni për dokumentin strategjik në funksion të këtij ligji, por këtu nuk na keni sjellë PBA-në e të gjithë sektorëve. Po e lexoj ashtu siç e keni shkruar: “Kostot e implementimit të këtij dokumenti strategjik, i cili është dokumenti i këtij ligji, që miratohet me VKM...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, shumë mirë, ky ligj kërkon që qeveria të miratojë një dokument strategjik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, do të bëni edhe planin tjetër. Tani po ju lexoj se çfarë shkruani: “Kostot përmbledhin masat kombëtare dhe përbëjnë kostot e implementimit të vetë ligjit”. Besoj se për këtë ligj e keni fjalën. Për pasojë, kur thua transporti, nuk ke thënë se sa do të kushtojnë rrugët e reja të Shqipërisë. Atëherë, nëse 60 miliardë lekë të rinj, që do të thotë rreth 120 milionë euro...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, 120 milionë euro do të shkarkojë sektori i transportit në vitin 2020? Lexoni se çfarë keni shkruar! Ju thoni: “Kostot e implementimit të dokumentit strategjik janë edhe vetë kostot e implementimit të ligjit”. Lexojeni dhe pastaj më jepni një analizë sipas sektorëve. Mua më tërhoqi vëmendjen që është shumë i madh, vitin tjetër është 120 milionë euro, pra sa 1% e GDP-së së Shqipërisë. Nëse këto lekë do t’i përdorë Ministria e Transportit për të bërë rrugët e Shqipërisë, atëherë çfarë lidhje kanë me këtë ligj? Në fillim u përgjigjët se janë të parashikuara në PBA-të e ministrive, po çfarë na duhen ne në këtë ligj se sa lekë ka ministria për të bërë rrugët e Shqipërisë? Pra këto 16 miliardë lekë dhe 15 miliardë në vitin 2021 çfarë janë? Nëse janë lekët e rrugëve çfarë lidhje kanë me këtë dokument? Ai që i ka vendosur nuk ka bërë përmbledhjen e PBA-së së Shqipërisë.

Niko Peleshi – Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Radhës tjetër na thatë se ju keni gjysmë njeriu, i cili ka edhe detyra të tjera, që do të merret me këtë punë. Si do të bëhet monitorimi dhe vlerësimi pa shtuar burime të tjera njerëzore për ta fuqizuar këtë sektor, sepse do të ketë një punë voluminoze? Mua më duket e papranueshme të thuhet se nuk ka kosto. Më mirë të jemi realistë dhe të shtojmë kapacitetet që kur ky ligj të hyjë në fuqi të mos bëjmë sikur jemi në rregull me BE-në se e

miratuam dhe pastaj, siç del zakonisht në raportet e tyre, ne kemi probleme me zbatimin e ligjit. Pra, a jemi realistë, sepse më duket pak e dyshimtë?

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Ligji, me gjithë trendet europiane e botërore, për sa i përket ruajtjes së mjedisit, duket i gjetur dhe falënderoj ministrinë për prezantimin e tij. Unë i bashkohem shqetësimit të dy kolegëve, Baraj dhe Beqaj, për sa i përket implementimit. Edhe nga përvoja, edhe nga ligjet që kemi miratuar në parlament, por edhe nga monitorimi që ne i bëjmë zbatimit të ligjeve të miratuara këtu, rezulton që në fillim janë ambicioze dhe pastaj nga puna dhe ngarkesa vonohen në aktet nënligjore, vonohen në ngritjen e strukturave, vonohen në rritjen e kapaciteteve e të tjera me radhë dhe realisht zbatimi nuk është në nivelin e duhur. Prandaj sugjerimi do të ishte: kohën e hyrjes në fuqi të ligjit ta rishikoni me objektivitet, më shumë për t'ju ndihmuar juve dhe të punoni për të nxjerrë aktet nënligjore që sapo të hyjë ligji në fuqi, ju t'i miratoni që të fillojë realisht zbatimi i tij, sepse pastaj ngelet në letër siç ndodh shpesh.

Për sa i përket pyetjes që bëri kolegu Baraj për kapacitetet, në fakt, nga raportet e Komisionit European, në përgjithësi ka rezultuar që nuk është bërë progres në kapacitetet institucionale, për sa u përket ndryshimeve klimatike. Prandaj edhe unë jam skeptike dhe dua të di pak më shumë se çfarë kapacitetesh reale keni ju si ministri dhe si institucione të varësisë që të njihni, monitoroni, matni dhe raportoni ndryshimet klimatike. Është përgjegjësi e madhe.

Si e keni menduar të trajtoni apo të rrisni kapacitetet e tyre, për të pasur ekspertizën e duhur, për ta realizuar në praktikë këtë ligj? Deri tani Agjencia Kombëtare e Mjedisit mat shkarkimet apo ndotjet në mjedis dhe shpeshherë bizneset vetë deklarojnë. Realisht ka pasaktësi, ka fiktivitet edhe në vetëdeklarim, por, ndërkohë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kapacitete për ta monitoruar këtë gjë në të gjithë vendin. Si keni menduar ta realizoni? Çfarë do t'i ndodhë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, do të shtohet stafi, do të trajnohen, do të merrni ekspertizë të huaj? Do të rrisni përgjegjshmërinë e biznesit? Se edhe biznesi, që t'i bëjë të gjitha këto ndryshime, duhet të paguajë disa kosto ekstra. A është i gatshëm ta bëjë këtë?

Ndërkohë, për sa i përket pjesës së bashkëpunimit, unë kam dëgjuar që Ministria e Energjisë, në mos gaboj, bën një plan veprimi për klimën dhe një për energjinë, por nuk e di sa konvergojnë dhe si janë të koordinuara me njëri-tjetrin, thjesht për të qenë në sinkron ose në sinergji.

Pyetja e fundit është: si i keni kapacitetet ju, se ndoshta vërtet ligji mund t'ju ndihmojë edhe për të marrë fonde nga Bashkimi European, por çfarë do të bëni për t'i rritur këto kapacitete për të përthithur fonde nga BE-ja për ndryshimet klimatike?

Faleminderit!

Ornela Çuçi – Faleminderit, zonja Gjermani, por, në fakt, unë do të flas vetëm për pikën e fundit që prekët! Mandej, do t'ia lija fjalën specialistes sonë të ministrisë, nëse është e mundur, me lejen tuaj, për ndryshimet klimatike.

Për sa u përket fondeve, na duhet patjetër ligji për tri fondet e mëdha që funksionojnë sot në të gjithë botën. Në fakt, edhe grupime të vendeve *Non-Annex I*, siç jemi edhe ne, marrin sot në të gjithë botën dhe janë *Green Climate Fund* dhe *Global Environment Facility*, pastaj janë edhe fondet e BE-së.

Nga të dyja këto fonde, ne sot si vend jemi të ngjashëm vetëm me dy-tri vende të tjera, dhe, në fakt, nuk kemi mundësi të aksesojmë më tepër, për shkak të mosmiratimit të ligjit.

Mjaftohemi vetëm në pesë vjet, ndërkohë që, së paku, do të duhet që nga *Green Climate Fund* për *readiness*, për projekte të mëdha, të kishim aksesuar 5 milionë dollarë amerikanë, ndërkohë që sot kemi aksesuar vetëm 300 000, të cilat nuk i kemi zbatuar ende. Kjo ka të bëjë vetëm e vetëm me faktin se nuk kemi ende kuadrin ligjor, madje as strategjinë nuk e kishim deri dje, për ndryshimet klimatike. Nga ana tjetër, edhe në GEF, sot për sot, ne si vend jemi ndër të vetmit që mjaftohemi vetëm me *GEF-STAR Allocations*. Nuk shkojmë përtej pikërisht për këto probleme, sepse nuk kemi bërë gati bazën, që ka të bëjë me kuadrin ligjor dhe strategjinë, për t'i aksesuar të dy këta komponentë, njërin prej të cilëve e keni përpara sot, ndërsa tjetrin e kemi miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Komponenti i tretë, që është shumë i rëndësishëm, ka të bëjë me qëndrueshmërinë e të gjithë kësaj, si dhe me qëndrueshmërinë në univers të të gjithë kësaj. Pra, në kuadër të “Paktit për universitetin”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me ndihmën e projekteve që merren nga këto dy fonde të mëdha, edhe pse fondet që ne kemi aktualisht nuk janë vërtet shumë të mëdha, kemi marrë dhe po punojmë për një master shkencor në Universitetin Politeknik ndërfakultativ për ndryshimet klimatike. Është i pari master që ndodh, në fakt, në të gjithë rajonin. Ndaj shpresojmë që i gjithë rajoni ta përqafojë dhe të bëhet njëri nga masterat e parë në të gjithë Ballkanin për të mos blerë më ekspertizë të huaj për ndryshimet klimatike, por të kemi ekspertizën tonë.

Për sa i përket faktit që, së paku, në dhjetë vjetët e fundit është punuar shumë në mënyrë sporadike me projekte të ndryshme për ndryshimet klimatike, të gjitha stafet e

ministrisë sonë dhe jo vetëm të ministrisë sonë, pasi ndryshimet klimatike janë ndërsektoriale (pra prekin disa ministri), edhe stafet e agjencive janë trajnuar herë pas here për ndryshimet klimatike. Pra, kemi ekspertizë të trajnuar, jo ekspertizë që e marrim të gatshme nga universiteti, ndaj po i rregullojmë të dyja këto çështje.

Po ia kaloj fjalën tani specialistes së ministrisë.

Eneida Rabdishta – Përshëndetje!

Unë quhem Eneida Rabdishta, punoj si specialiste në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe mbuloj fushën e ndryshimeve klimatike.

Lidhur me subjektet, përveç asaj që thanë parafolëset, dua të sqaroj se ato nuk do të kenë kosto shtesë, e përsëris, deri në momentin kur do të jemi shtet anëtar dhe lind detyrimi nga kuadri ligjor i BE-së që të punojmë për reduktimin e gazeve serrë. Por, fillimisht, ato thjesht në lejen e mjedisit, që tashmë e kanë marrë nga AKM-ja, do të kenë një aneks ku do të raportojnë për këto gaze me efekt serrë. Kjo do të bëhet nëpërmjet një përlllogaritjeje të formulës: në bazë të lëndës djegëse që ato përdorin dhe të asaj çka prodhojnë, që do të nxjerrë se sa emetime lëshojnë gazet në ajër.

E dyta, në lidhje me koston e strategjisë, ashtu siç tha zoti Beqaj, kur shikon shifrat duken vërtet të frikshme dhe, në fakt, ne nuk kemi pasur pak pengesa edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për t'i bindur ato në lidhje me këto kosto. Por ju sjell në vëmendje edhe një herë se ky ligj nuk do të ketë kosto shtesë. E vetmja kosto që do të ketë, është kostoja e parashikuar nga ministritë e linjës në PBA.

Dokumenti strategjik i ndryshimeve klimatike përbëhet nga dy plane veprimi, të cilat kanë masat që janë marrë nga dokumente që ato tashmë i kanë të miratuara. Kur shikojmë koston e transportit, vërtet mund t'ju duket një kosto e lartë, por është kosto që atyre iu është miratuar në PBA, u është miratuar në dokumentet e tyre strategjike dhe në planet e veprimit.

Një ndër masat që kjo ministri planifikon të ndërmarrë në fushën e transportit është ndërtimi i rrugëve, por besoj, të gjithë e dimë se këto rrugë duhet të jenë edhe në përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, si, për shembull, për shkak të përmbytjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, janë kostot e veprimit të ministrive. Por ky ligj nuk do të ketë asnjë kosto shtesë, mbi të gjitha, në katërvjeçarin e parë.

Nëse i shikoni tabelat, në fund të tyre ne kemi shkruar që hendeku financiar përbën efektivisht kostot e implementimit përtej vitit 2022. Pra, deri më 2022 do të jetë thjesht kosto administrative, e cila është e vendosur tashmë në të gjitha ministritë e linjës.

Në lidhje me kapacitetet, është shumë e vërtetë që kemi nevojë gjithnjë për më tepër, por, nëse ne nuk hartojmë një kuadër ligjor që do t'i hapë rrugën kësaj lloj kërkesë, atëherë mendoj se i bie të ngelim në vend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është sektor. Ka qenë në çdo raportim dhe në çdo nënkomitet ku ne kemi qenë. Ata kërkojnë që të kemi minimumi një sektor. Por, kur na thuhet që nuk ka kosto shtesë, dhe besoj dihet që Ministria e Mjedisit ka PBA-në me vlerën më të vogël... Domethënë, kur ne këtë gjë e kërkojmë gjatë gjithë kohës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne të katërt sa jemi këtu, se nuk po i numërojmë dot...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ornela Çuçi – Mund të flas unë.

Atëherë, ne kemi një drejtori që merret me të gjitha këto çështje, por ka vetëm një person për ndryshimet klimatike dhe një person për emetimin e gazeve në ajër, që, praktikisht, janë dy në kuadër të këtij ligji. Nga ana tjetër, aktualisht Agjencia Kombëtare e Mjedisit po riformatohet dhe shpresojmë që të na miratohet sektori për ndryshimet klimatike brenda në Agjenci.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Në fakt, kam një këshillë tepër modestisht. Kujtoj që, sado problematika e mbetjeve në Shqipëri vazhdon të mbetet jashtëzakonisht kritike, me të gjitha përmirësimet e bëra kohët e fundit, në ministri para dhjetë vjetësh ishte vetëm një person që merrej me problematikën e mbetjeve urbane në Shqipëri. Pra, lidhur me ekspertizën që ofron në përgjithësi qeveria, mund të them se ka gjithnjë probleme me kapacitetet dhe ka gjithnjë nevojë për shtimin e tyre.

Megjithatë, në këto rrethana, duke pasur parasysh hendekun ndërmjet qeverive dhe universitetit, që ka një potencial të jashtëzakonshëm dhe njerëz shumë seriozë, pavarësisht paragjykimëve që mund të kenë, që mund të përfshihen dhe të luajnë atë rol që luajnë universitetet në vendet e ndryshme të botës, në Shqipëri nuk e kemi gjetur atë komunikim apo një mënyrë bashkëpunimi që problematika reale e vendit, e administruar nga qeveria, të ketë mundësi që t'i ushqejë universitetet edhe me burime financiare në përgjigje të një pune që ato bëjnë, që është shumë cilësore dhe shumë e dobishme.

Kështu që është një mundësi që, nëpërmjet këtij ligji, pavarësisht se ju thatë që ne kemi kapacitete, ta shtrini këtë lloj aktiviteti dhe të përfshini edhe universitetet. Ato do t'ju

japin atë që duhet edhe në këmbim të një ushqimi, oksigjeni, që kanë ato për burimet financiare, të cilat mungojnë kaq shumë.

Ishte thjesht një këshillë.

Ornela Çuçi – Një fjali, për të mos ju ngrënë më shumë kohë edhe juve.

Profesor, faleminderit shumë për sugjerimin, i cili është jashtëzakonisht shumë i drejtë!

Mjedisi është një çështje thellësisht teknike, shumë më tepër teknike dhe ekspertizë sesa është politike, në fakt. Ju keni shumë të drejtë për faktin se ekspertiza më e mirë sot për sot në vend është ajo akademike.

Edhe në kuadër të kësaj, në ministri kemi një këshill, i cili quhet Këshilli i të Urtëve, i formuar që ditën e parë, kur ne kemi ardhur në këtë ministri, ku në përbërje ka akademikë të dalë në pension, akademikë aktualë, dekanë të universiteteve që lidhen krejtësisht me çështjet e mjedisit, të cilët mblidhen një herë në muaj në ministri për çdo çështje që ne kemi aktualisht në diskutim, por, nga ana tjetër, edhe për çdo çështje që lind nga momenti në moment, ata mblidhen dhe i japin këshilla ministrisë për këtë gjë.

Gjithashtu, do të doja të thosha që të tria projektet që kanë të bëjnë 100% me çështjet e ndryshimeve klimatike sot, të marra nga organizma, nga agjenci ligjzbatuese të mëdha, siç janë PNUD-i, UNEP-i e të tjera, janë 100% të deleguara për bashkëpunim me universitetet. I tillë është projekti i madh, i katërt “Komunikim kombëtar për emetimin e gazeve në ajër”; i tillë është NAP-i (*National Adaption Fund*), që shpresojmë të fillojë në datën 1 janar në Shqipëri, që është i pari, si dhe projekti tjetër, i marrë nga fondet e adaptimit sot në vend. Të gjitha janë të fokusuara në universitete pikërisht për këtë çështje.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni.

Halit Valteri – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë besoj që në kuadër të të gjithë asaj që thanë kolegët, shpreh mendimin tim. Madje, nga i gjithë diskutimi kuptova se ne në parim nuk jemi kundër këtij ligji apo diskutimi për të.

I vetmi shqetësim është nëse i kemi kapacitetet për ta zbatuar, në mënyrë që të mos bëjmë një ligj, e para, që të mos ngelet në letër dhe, e dyta, që ky ligj të mos kthehet në një çekiç më shumë ndaj bizneseve shqiptare që, edhe në këtë kuadër, siç jemi sot, ka mjaft çekiçe që shkojnë t’u trokasin në derë.

Pra, duhet të kuptojmë drejt se në parim ne jemi dakord që ky ligj në një moment duhet të fillojë, duhet ta diskutojmë, që mund të jetë sot ose nesër, por sot e kemi përpara dhe besoj këtu shpreh edhe mendimin e kolegut, që ne duhet ta diskutojmë, por shqetësimet janë dy.

Së pari, a i kemi kapacitetet?

Së dyti, a jemi në kohën e duhur për ta futur në fuqi pas gjashtë muajsh për ta zbatuar?

Me sa kuptova, këto janë edhe pikat për të cilat ne, kur të vijojmë me diskutimin e këtij ligji, do të hasim në një debat dhe në një diskutim më të gjerë, ndoshta edhe në terma teknike që pastaj mund ta hasim nen për nen. Por në parim unë besoj që ne të gjithë këtu jemi dakord për ta diskutuar dhe për ta kaluar këtë lloj ligji. Por a i kemi kapacitetet? Pra, a keni mundësi ju që këtë ligj, të cilin do ta kalojmë këtu, ta zbatoni dhe ta implementoni siç duhet?

E dyta, a do të kthehet ky ligj pastaj në një kosto shtesë për bizneset shqiptare? Këto janë dy shqetësimet që u ngritën këtu.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Atëherë, e mbyllim këtu diskutimin. Pasi të marrim edhe opinionet e komisioneve të tjera parlamentare, kryesisht të Komisionit për Integrimin European, do të vijojmë me shqyrtimin në parim dhe nen për nen, ku patjetër do të ketë shumë diskutime dhe pyetje të tjera për çdo nen, pasi çdo nen prek grupime të caktuara, qoftë përdoruesit e makinave, qoftë prodhuesit e të tjerë.

Gjej rastin të falënderoj përfaqësuesit e ministrisë për seriozitetin dhe për të gjitha sqarimet! Është një ligj shumë i rëndësishëm, patjetër, janë të nënkuptuara edhe kostot, edhe detyrimet që kemi për të ecur përpara me axhendat globale.

Rasti e ka sjellë që jam edhe vetë firmëtar në emër të shtetit shqiptar për Marrëveshjen e Parisit. Kështu që, nuk kam çfarë të bëj, nuk e diskutoj dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit të gjithëve!

Mbledhja e radhës do të njoftohet nga sekretaria.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA